



TË DËGJOHET ZËRI YNË

Gjetja e mundësive për të rinjtë dhe femrat në gjyqësor
dhe në profesionin ligjor në Kosovë

Qershor 2015

TË DËGJOHET ZËRI YNË

Gjetja e Mundësive për të Rinjtë dhe Femrat në Gjyqësor
dhe në Profesionin Ligjor në Kosovë
Qershor 2015

Qershor 2015

Ky studim është kryer nga Florije Manaj-Zogaj, Eksperte Ligjore dhe është redaktuar nga Violaine Autheman, Menaxhere e Lartë e Programit, me mbështetje nga Qendra Kombëtare për Gjykata Shtetërore (NCSC). Ndhmë shtesë për studime në terren u ofrua nga Suzana Manaj, studente e juridikut në vitin e katërt në FJUP, Rita Matoshi, studente e juridikut në vitin e katërt në FJUP dhe Donika Kllokoqi, studente e vitit të dytë, Kolegji Iliria - Fakulteti Juridik. Rebecca Castellucci, Bashkëpunëtore e Projektit të Qendrës Kombëtare për Gjykata Shtetërore, dhe John Satira, student i vitit të parë në fakultetin juridike "William and Mary School of Law" kanë bërë analiza dhe redaktim shtesë.

Përmbajtja

Lista e akronimeve.....	3
Përmbledhje ekzekutive.....	4
Hyrje.....	7
Historiku dhe konteksti	8
Metodologjia	10
Analiza e të gjeturave	11
Profilët e femrave dhe të rinjve në fuqinë punëtore ligjore: Të dëgjohet zëri ynë përmes profesionalizmit dhe mundësive të reja.....	27
Rekomandimet dhe hapat e ardhshëm.....	32
Përfundim	34
Shtojcë 1: Rreth Qendrës Kombëtare për Gjykatat Shtetërore.....	35
Shtojcë 2: Anketa e Iniciativës Hulumtuese për të Rinjtë dhe Femrat, studentët.....	36
Shtojcë 3: Anketa e Iniciativës Hulumtuese për të Rinjtë dhe Femrat, profesionistët.....	45
Shtojcë 4: Lista e intervistave dhe diskutimeve më rupe të fokusuar	54

Figurat

Figura 1: Mostra e anketës	10
Figura 2: Të anketuarit profesional sipas profesionit	12
Figura 3: Regjistrimi i studentëve të juridikut në programet e praktikës.....	12
Figura 4: Moshë e të anketuarve	13
Figura 5: Motivimi për ndjekjen e karrierës ligjore.....	14
Figura 6: Krahasimi i aspiratave dhe planeve për karrierë në mesin e studentëve të juridikut	15
Figura 7: Niveli i përgatitjes për fuqinë punëtore pas diplomimit	17
Figura 8: Numri i profesionistëve është "mjaftueshëm"	18
Figura 9: Numri i profesionistëve është "shumë i ulët"	18
Figura 10: Numri i profesionistëve është "shumë i lartë"	18
Figura 11: Perspektiva e avancimit.....	19
Figura 12: Perceptimet e sfidave për femrat në fuqinë punëtore ligjore.....	21
Figura 13: Preferencat e nxitura nga gjinia në mesin e palëve dhe klientëve.....	23
Figura 14: Perceptimet e kundërta për vendin e punës në mesin e femrave gjyqtare dhe avokate	23
Figura 15: Perceptimet e kundërta për sfidat në mesin e femrave gjyqtare dhe avokate.....	23
Figura 16: Nevoja për karrierë të suksesshme	24
Figura 17: Çfarë ju nevojitet që të arrini sukses në karrierën tuaj ligjore?.....	24
Figura 18: Kushtet për të tërhequr të rinjtë dhe femrat në fuqinë punëtore ligjore	25

Lista e akronimeve

CLARD	Qendra për Ndhmë Juridike dhe Zhvillimi Rajonal
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
PJK	Programi për Juristët në Kosovë
NCSC	Qendra Kombëtare për Gjykatat Shtetërore
DGF	Diskutime të Grupeve të Fokusuara
IIK	Intervista me informues Kyç
OJQ	Organizata Joqeveritare
FJUP	Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës
UPHZ	Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, Fakulteti Juridik
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Përmbledhje ekzekutive

Sfida për të lidhur të rinjtë dhe fuqinë punëtore ka kohë që është kuptuar si një problem thelbësor për zhvillim në Kosovë. Pas më shumë se një dekade të asistencës për profesionin e juristit, situata nuk ka ndryshuar në fushën ligjore. Nëpërmjet këtij studimi, ne bëjmë pyetje pse dhe si.

Në prill 2015, Qendra Kombëtare për Gjykata Shtetërore (NCSC) në Kosovë ka filluar një Iniciativë Huluntuese për të Rinjtë dhe Femrat, për të analizuar pengesat, të vërtetat dhe të perceptuarat të të rinjve që hyjnë në profesione të sektorit të drejtësisë pas më shumë se një dekade të ndihmës nga komuniteti i donatorëve. Kjo nismë ndërtohet mbi një projekt kërkimor paraprak, *Numrat që kanë rëndësi*, i cili ka prodhuar një analizë të të dhënave të anëtarësimit të profesionit juridik në Kosovë dhe ka konstatuar se ekziston një deficit rinie brenda profesionit ligjor në Kosovë. *Numrat që kanë rëndësi* ishte përgatitur nga Programi për Juristet në Kosovë (PJK), një program tre-vjeçar i financuar nga Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatuar nga NCSC midis janarit 2012 dhe marsit 2015. Në një aktivitet partneriteti të organizuar në mars 2015 nga PJK në partneritet me dy universitetet partnere, Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (FJUP) dhe Fakultetin Juridik të Kolegjit Iliria dhe me Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK), panelistët kanë konkluduar se duhet bërë më shumë për të kapërcyer hendekun në mes arsimimit juridik dhe profesionit juridik për të tërhequr një brez të ri të profesionit të avokatës, meshkuj dhe femra në fuqi punëtore. Ky raport synon të informojë për përpjekjet për të trajtuar deficitin/mos-përfshirjen e rinisë në fuqinë punëtore ligjore duke hartuar aspiratat, shqetësimet dhe sfidat e të rinjve kosovarë të diplomuar në juridik për të hyrë dhe qëndruar në profesionin juridik.

Hulumtimi u krye në mes të prillit dhe qershorit 2015 nga një ekip i hulumtuesve të terrenit koordinuar nga znj. Florije Manaj-Zogaj, Eksperte Ligjore. Hulumtimi ka përfshirë shpërndarjen e pyetësorëve, diskutimet me grupe të fokusuara, intervistimin e informuesve kyç për të mbledhur informacione për kufizimet dhe mundësitë për hyrjen, avancimin dhe zhvillimin profesional të të rinjve dhe femrave si juristë, gjyqtarë dhe profesionistë tjerë të sektorit të drejtësisë. Grupet e synuara kanë përfshirë gjykatës meshkuj dhe femra, avokatë, prokurorë, juristë që punojnë në sektorin publik dhe privat, anëtarë stafi të gjykatës, fakultete juridike dhe studentë të juridikut. Iniciativa Huluntuese për të Rinjtë dhe Femrat po ashtu ka përfshirë anketa dhe diskutime në grupe të fokusuara me studentë dhe praktikantë për të marrë informata të rëndësishme nga juristët e rinj, të cilët janë të gatshëm të hyjnë në profesionin ligjor dhe për të marrë mendimet e tyre për aspiratat e tyre profesionale pas diplomimit. Iniciativa Huluntuese për të Rinjtë dhe Femrat është hartuar për të informuar shoqatat profesionale dhe partnerët e zhvillimit për atë se si të përkrahet rinia dhe juristet femra nëpërmjet mundësive të zhvillimit profesional dhe për fuqizimin e tyre për t'u bërë anëtarë aktiv në fuqinë punëtore ligjore.

Me anë të Iniciativës Huluntuese për të Rinjtë dhe Femrat, NCSC mblodhi një total prej 156 përgjigjeve nga pyetësorët dhe ka kryer 15 intervista me informues kyç dhe gjashtë diskutime me grupe të fokusuara. Në popullsinë e anketës janë përfshirë 100 studentë dhe 56 profesionistë të sektorit të drejtësisë, me 94 të anketuar femra dhe 58 meshkuj. Të anketuarit profesionistë përfshinin 19 avokatë, 14 gjyqtarë, dhe 12 prokurorë. Pjesa e mbetur prej 10 ishin profesionistë që punojnë në sektorin e drejtësisë si administratorë të gjykatave, bashkëpunëtorë dhe referentë ligjor, zyrtarë nga Ministria e Drejtësisë, si dhe punëtorë të OJQ-ve.

Gjetjet kryesore të anketave, intervistave dhe diskutimeve në grupe të fokusuara tregojnë një nevojë për rritjen e qasjes në praktikë dhe rrjetëzim për të lehtësuar qasjen në fuqinë punëtore ligjore. Midis profesionistëve, gjetjet kryesore theksojnë nevojën për të fuqizuar femrat si një nëngrup i profesionistëve përmes mundësive të avancimit dhe pjesëmarrjes në udhëheqje. Gjatë hulumtimit, sfidat

më të rëndësishme për të rinjtë dhe femrat janë identifikuar të jenë: (1) mungesa e mundësive praktike që u mundësojnë studentëve ose të rinjve të sapo diplomuar të përcaktojnë e një drejtim karriere brenda fuqisë punëtore ligjore; (2) papunësia; (3) mundësi të pamjaftueshme të zhvillimit profesional në formë të praktikës së punës; dhe (4) rolet e kufizuara të udhëheqjes për profesionistet femra që rezultojnë në kufizime të vet-imponueshme në karrierë për femrat e reja.

Megjithëse të anketuarit kanë përmendur nevojën për fuqizimin e mëtejshëm, të rinjtë dhe femrat kanë aspiratën dhe motivimin për të arritur sukses në karrierën e tyre dhe për të ndikuar ndryshimin pozitiv. Gati 80% e femrave profesioniste të anketuara kanë deklaruar se ato shpresojnë të qëndrojnë në profesionin ligjor për 10 vitet e ardhshme. Më shumë se 70% e profesionistëve të anketuar (dhe më shumë se 60% e studentëve) thanë se ata kanë zgjedhur të hyjnë në profesionin ligjor për të siguruar drejtësinë dhe më shumë se 40% e profesionistëve të anketuar (dhe më shumë se 50% e studentëve) për të ndryshuar shoqërinë. Dhe e fundit, më tepër se 25% e profesionistëve të intervistuar (dhe më shumë se 55% e studentëve të anketuar) kanë vendosur për vijimin e karrierës në sektorin e drejtësisë ose për të mësuar të drejtat e tyre ose për të mësuar të tjerët për të drejtat e tyre.

Bazuar në të gjeturat, rekomandime fokusohen në përmirësimin e zhvillimit profesional për profesionistët ligjor, rritjen e mundësive praktike për të rinjtë e sapo diplomuar, dhe zhvillimin e roleve të udhëheqjes për femrat profesioniste. Rekomandimi i parë është të forcohen mundësitë e zhvillimit profesional për meshkujt dhe femrat e profesionit ligjor nëpërmjet partneritetit midis Qendrës së Trajnimit të OAK-së, Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe fakulteteve juridike. Rekomandimi i dytë është inkurajimi i të diplomuarve të rinj për të hyrë në fuqinë punëtore ligjore duke lehtësuar më shumë mundësitë e mësimit praktik përmes praktikës dhe duke promovuar fuqizimin e femrave të reja dhe studentëve të juridikut, avokatëve dhe gjyqtarëve përmes fushatave të vetëdijesimit dhe mediave sociale. Rekomandimi përfundimtar është të promovohet roli i udhëheqjes i femrave profesioniste dhe mobilizimi i femrave të suksesshme në profesionin ligjor që të bëhen model i udhëheqjes për femrat e reja.

Fakte të shkurta 2015

- Janë anketuar 156 studentët kosovarë të juridikut, gjykatës dhe profesionistë ligjorë.
- Janë kryer 15 intervista me informues kyç dhe gjashtë diskutime me grupe të fokusit.
- Personat e tregut të fuqisë punëtorë në Kosovë kanë përfaqësuar 40% të popullsisë. Në vitin 2015, ka pasur 573 avokatë të licencuar të cilët janë licencuar nga OAK dhe 358 gjyqtarë dhe 137 prokurorë të emëruar në shtatë divizione të gjykatave themelore.
- Fuqia punëtore ligjore shënohet me një deficit (mos-përfshirje) të të rinjve dhe përfaqësim të ulët të femrave. Fuqia punëtore ligjore po plakët me shpejtësi në të gjitha profesionet, me 79% të avokatëve, 61% të prokurorëve, dhe 54% të gjyqtarëve mbi moshën 50 vjeç. Vetëm 2% e avokatëve janë nën moshën 30 vjeç dhe vetëm 9% të gjyqtarëve dhe 4% të prokurorëve nën moshën 35 vjeçare. Nga ana tjetër, rinia përbën 56% të fuqisë punëtore në Kosovë.
- Femrat në përgjithësi janë të nën-përfaqësuara në fuqinë punëtore ligjore të Kosovës, që përbëjnë vetëm 21%. Femrat përfaqësojnë 37% të profesionit të prokurorit, 29% të profesionit të gjyqtarit, 27% të profesionit të noterit, dhe 13% të profesionit ligjor.
- 85% e profesionistëve të anketuar u janë përkushtuar profesioneve të sektorit të drejtësisë për një periudhë afatgjatë, ndërsa 72% e studentëve të anketuar u janë përkushtuar profesioneve të sektorit të drejtësisë për një afat të shkurtër.
- Më shumë se 60% e të anketuarve kanë zgjedhur të hyjnë në profesionin gjyqësor ose ligjor për të siguruar drejtësi apo nga të pasurit e një dëshire për të ndryshuar shoqërinë.
- Më shumë se 92% e të intervistuarve kanë raportuar një përvojë pozitive gjatë studimit në fakultetin juridik.
- Më shumë se 86% e të anketuarve janë pajtuar se meshkujt dhe femrat kanë qasje të barabarta në arsimin ligjor.
- Shumica e të anketuarve kanë perceptuar të ketë barazi gjinore në sektorin e drejtësisë, me 82% që konsiderojnë se meshkujt dhe femrat kanë të njëjtat mundësi pune dhe praktike dhe 67% konsiderojnë se perspektivat për avancim janë në dispozicion në mënyrë të barabartë për profesionistë meshkuj dhe femra.
- 53% e profesionistëve të anketuar nuk u pajtuan se femrat ballafaqohen me pengesa kur punojnë në sektorin e drejtësisë, krahasuar me 52% të studentëve të cilët besonin se femrat ballafaqohen me pengesa kur punojnë në sektorin e drejtësisë.
- Me gjithë barazinë gjinore sa u përket mundësive, femrat besonin se kanë pasur ndikim të pabarabartë në krahasim me meshkujt, me më shumë se 30% e të anketuarve u përgjigjen se meshkujt dhe femrat nuk marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrje në institucionet e sektorit të drejtësisë, dhe meshkujt dhe femrat nuk kanë qasje të barabartë as në rolet udhëheqëse.
- Perspektiva e meshkujve paraqet një tablo të ndryshme, me 88% të të intervistuarve që deklarojnë se meshkujt dhe femrat kanë të njëjtat mundësi punësimi dhe 90% duke u shprehur se meshkujt dhe femrat trajtohen njëjtë në vendin e punës.
- Hulumtimi gjithashtu vuri në dukje një ndryshim ndërmjet perceptimit dhe përvojës, me më shumë se 80% e të anketuarve femra që renditin mundësitë e zhvillimit profesional si nevojën më të madhe që ato të kenë sukses në karrierat e tyre.
- Meshkujt kanë perceptime më të larta sesa femrat të besojnë se femrat janë të nën-përfaqësuara në gjyqësor, pasi që 55% e të anketuarve studentë meshkuj dhe 55% e të anketuarve profesionistë meshkuj besonin se numri i gjyqtarëve femra ishte tepër i ulët. Vetëm 45% e të anketuarve femra studente dhe 43% e të anketuarve profesionistë besonin se numri i femrave gjyqtare ishte tepër i ulët.

Hyrje

Pavarësisht investimeve prej më shumë se një deкаде për shtrirjen tek grupet e nën-përfaqësuar brenda fuqisë punëtore ligjore, profesionet e sektorit ligjor në Kosovë mbeten të prekura nga deficieti/mos përfshirja e rinisë dhe gjinisë. Më shumë se gjysma e gjyqtarëve, prokurorëve, dhe avokatëve janë mbi moshën 50 vjeç dhe profesionistët nën moshën 35 vjeç përbëjnë më pak se 10% të fuqisë punëtore ligjore. Derisa përfitime të konsiderueshme janë arritur në barazinë gjinore brenda këtyre profesioneve, femrat mbeten vetëm një e treta e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe vetëm 13% e avokatëve dhe përfaqësimi i tyre në pozita udhëheqëse në fuqinë punëtore është i kufizuar, duke rezultuar në një mungesë të rrolit të modeleve për brezin e ardhshëm.

Qëllimi i Iniciativës Hulmuese për të Rinjtë dhe Femrat, është të identifikojë sfidat kryesore dhe kërkesat strategjike të studentëve të juridikut të Kosovës, meshkuj dhe femra, me një theks tek femrat e reja të diplomuara, dhe për të caktuar prioritetet e veprimeve që mund të plotësojnë zbrazëtinë ndërmjet arsimit dhe hyrjes në fuqinë punëtore ligjore. Studimi po ashtu dokumenton sfidat kryesore dhe nevojat strategjike të femrave gjyqtare, prokurore, dhe profesionistëve ligjor për të identifikuar mundësitë për zhvillimin profesional që u përshtaten më së miri këtyre nevojave.

Iniciativa Hulmuese për të Rinjtë dhe Femrat, ka konfirmuar supozimin se të anketuarit profesionale mendojnë se në përgjithësi ekziston barazi në arsimimin dhe trajnimin ligjor, ndonëse rolet e udhëheqjes janë të rezervuara për meshkuj dhe jo për femra. Studimi tregoi gjithashtu se të studentët e anketuar, profesionistët e rinj të së ardhmes së Kosovës janë të etur për të filluar karrierën ligjore për të marrë pjesë në ndryshimin e shoqërisë dhe për të siguruar drejtësinë, por se atyre u nevojitet zhvillim profesional i mëtejshëm dhe praktikë e orientuar për të zgjedhur një rrugë karriere dhe për t'u përgatitur për hyrje në fuqinë punëtore ligjore.

Gjetjet e anketës tregojnë zbrazëtitë ndërmjet perceptimit dhe përvojës. Përderisa vetëm gjysma e të anketuarave profesionale femra treguan se femrat që punojnë në sektorin e drejtësisë vlerësohen, respektohen dhe trajtohen njëjtë nga familja dhe komuniteti, ato kanë pohuar se mungesa e mundësive të zhvillimit profesional, veçanërisht gradimit, paraqitet si sfida më e madhe e tyre për të hyrë dhe avancuar në gjyqësor dhe në profesionin juridik, e jo diskriminimi gjinor. Në krahasimin e përgjigjeve nga të anketuarit meshkuj dhe femra, mospërputhje të vazhdueshme kanë qenë të dukshme në perceptimin e dinamikës gjinore nga meshkujt dhe femrat në gjyqësor dhe në profesionin ligjor.

Historiku dhe konteksti

Që nga dhjetori 2014, popullsia e Kosovës ishte 1.8 milion me 61% të popullsisë që jeton në zona rurale. Të rinjtë (të moshës 15-24) përbëjnë 55% të popullsisë së përgjithshme dhe femrat përbëjnë rreth 50%. Në vitin 2013, vetëm 41% e popullsisë në moshë pune (të moshës 15-65) kanë qenë ekonomikisht aktiv. Në tërësi, normat e punësimit janë regjistruar me 13% në mesin e femrave dhe 40% tek meshkujt. Midis qytetarëve aktivë ekonomikisht me moshë pune, 30% janë të papunë. Shkalla e papunësisë është veçanërisht e lartë në mesin e të rinjve dhe femrave. Siç raportohet, 39% e femrave dhe 56% e të rinjve në moshë pune ishin të papunë. Të rinjtë e papunë janë sa dy herë shkalla e papunësisë me moshë pune e moshës nga 25-65 vjeç. Femrat e reja kanë qenë veçanërisht të prekura me 68% të femrave të reja të papunë. Pjesëmarrja e femrave në fuqinë punëtore ishte 17% në vitin 2012 dhe 21% në vitin 2013, që do të thotë se hyrja e tyre në fuqinë punëtore është gradualisht duke u rritur. Të diplomuarit në universitet, duke përfshirë studentët e juridikut, kanë përfaqësuar 55% të të punësuarve në sektorin publik në krahasim me vetëm 14% të të punësuarve në sektorin privat. Kjo reflektohet në fuqinë punëtore ligjore me preferenca të shprehura për stabilitetin e profesioneve të sektorit publik (gjykatës, prokuror) ndaj pozitive të sektorit privat (avokat, noterë, përmbarues privat).¹

Në Kosovë, fakultetet juridike janë ndër fakultetet që pranojnë numrin më të lartë të studentëve çdo vit. FJUP, fakulteti më i madhi juridik, pranon rreth 1,000 studentë të rinj në vit. Në vitin akademik 2014-2015, FJUP ka pranuar 1.192 studentë të rinj, nga të cilët 633 ishin femra.² Që prej hapjes katër vjet më parë, Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" Fakulteti Juridik (UPHZ) ka regjistruar rreth 2,689 studentë, prej të cilëve 1,177 janë femra, si në programet e nivelit baçelor ashtu edhe master.³ Për vitin akademik 2014-2015, Kolegji Iliria ka 226 studentë, prej të cilëve 95 janë femra, si në programet e nivelit baçelor edhe në master.⁴

Për më shumë se katër vjet, Kosova është udhëhequr nga një presidente femër, Atifete Jahjaga. Gjatë presidencës së Jahjagës, pjesëmarrja e femrave dhe të rinjve në fuqinë punëtore është rritur çdo ditë. Megjithatë, Kosovës i mungojnë femrat në rolet e udhëheqjes dhe angazhimi i tyre në mënyrë aktive në sektorët tjerë profesional mbetet i ulët. Në sektorin e drejtësisë, numri i femrave gjyqtare, prokurore dhe avokate po ashtu ka shënuar rritje në vitet e kaluara, por këto femra vazhdojnë të përballen me sfidat në avancimin profesional në një kulturë dhe shoqëri dominuese patriarkale.

Fuqia punëtore ligjore shënohet me një deficit të të rinjve dhe përfaqësim të ulët të femrave. Në fillim të vitit 2015, janë 573 avokatë të licencuar nga OAK dhe 358 gjyqtarë dhe 137 prokurorë të emëruar në sistemin e drejtësisë prej tri nivelesh (p.sh., gjykata/prokuroria themelore, gjykata/prokuroria e Apelit dhe Gjykata Supreme dhe prokuroria e shtetit). Fuqia punëtore ligjore po plaket me shpejtësi në të gjitha profesionet, me 79% të avokatëve, 61% të prokurorëve, dhe 54% të gjyqtarëve mbi moshën 50 vjeç. Brenda OAK-së, moshë mesatare e anëtarësisë është 56.8 dhe gjysma e avokatëve të licencuar janë mbi moshën 60 vjeç. Vetëm 2% e anëtarëve të OAK-së nën moshën 30 vjeç. Rinia është e ngjashme e nën-përfaqësuar në profesionin gjyqësor dhe prokurorial me vetëm 9% të gjyqtarëve dhe të 4% të prokurorëve nën moshën 35 vjeçare.

Pavarësisht përmirësimeve në vitet e fundit si rezultat i përpjekjeve të përbashkëta për tërheqjen e femrave drejt fuqisë punëtore ligjore, femrat mbeten të nën-përfaqësuar në të gjitha profesionet e

¹ Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP), 2012-2013, Kosovë 2013 Anketa e Fuqisë Punëtore (www.esk.rks-gov.net)

² Të dhënat e ofruara nga administrata e FJUP-së në qershor 2015.

³ Të dhënat e ofruara nga dekani i Fakulteti Juridik i Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka" në qershor 2015. Numrat përfaqësojnë katër gjenerata studentësh (2011-2015).

⁴ Të dhënat e ofruara nga administrata e Fakulteti Juridik të Kolegjit Iliria në qershor 2015.

sektorit të drejtësisë. Më pak se 13% e anëtarëve të sotëm të OAK-së janë femra, me shumicën që veprojnë në zonat urbane, veçanërisht në Prishtinë.⁵ Femrat përbëjnë 29% të gjyqtarëve dhe rreth 36% të prokurorëve.

Ekziston një përpjekje e përbashkët për të kapërcyer hendekun gjinor dhe të rinisë dhe për të tërhequr më shumë femrat dhe të rinjtë të i bashkohen gjyqësorit dhe të hyjnë në profesionin ligjor. Femrat gjyqtare janë të pranishme në përqindje më të lartë në gjyqësorin e lartë. Gjykata Supreme e Kosovës ka një total prej 13 gjyqtarësh, përfshirë këtu edhe 5 femra (38%), por vetëm 2 nga 12 anëtarë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (17%). Në Gjykatën e Apelit, femrat përbëjnë një të tretën e 30 gjyqtarëve (33%). Dy Gjykatat Themelore, ajo e Pejës dhe Mitrovicës—udhëhiqen nga kryetaret femra dhe femrat përfaqësojnë midis rreth 20% të gjyqtarëve në Gjilan, Ferizaj dhe Mitrovicë, dhe rreth 25% në Gjakovë dhe Prizren, 30% në Pejë, dhe deri në 42% në Prishtinë.

Brenda shërbimit prokurorial, një femër kryeprokurore udhëheq Prokurorinë Speciale, dhe një femër po ashtu kryeson Prokurorinë Themelore në Gjakovë. Gjithashtu, tri femra prokurore janë pjesë e Prokurorisë Speciale dhe një femër prokurore shërben në Prokurorinë e Apelit.

Duke pasur parasysh se të rinjtë dhe femrat përbëjnë më shumë se gjysmën e fuqisë punëtore të mundshme në Kosovë, talentet e të rinjve dhe femrave nuk janë duke u shfrytëzuar sa duhet. Ekziston një deficit i qartë i të rinjve dhe femrave në kuadër të sektorit të drejtësisë që duhet të adresohet përmes promovimit dhe sigurimit të mundësive të barabarta për të rinjtë dhe femrat, me përfshirjen e bartësve adekuat për të garantuar ndryshime të qëndrueshme.

⁵ NCSC, Programi i USAID-it për juristët në Kosovë, "Numrat që kanë rëndësi", mars 2015.

Metodologjia

Metodologjia që është përdorur në Inicativën Hulomtuese për të Rinjtë dhe Femrat ka përfshirë qasjen e metodave të përziera, duke përdorur qasjen e kërkimit kuantitativ dhe kualitativ. Është kryer një studim me dy pyetësorë, një për studentët dhe një për profesionistët, duke përdorur pyetje të ngjashme për të matur perceptimet e mundësive, sfidat dhe barazinë gjinore në arsimimin ligjor dhe ambientet e punës, ndërsa gjithashtu duke identifikuar nevojat strategjike të trajnimit dhe mundësitë e zhvillimit profesional në mesin e popullatës së synuar. Hulumtimi ka shfrytëzuar pyetësorë të veçantë për të matur perceptimin dhe përvojën e profesionistit, si dhe për të matur perspektivën e studentëve për të ardhmen dhe perceptimin e aftësive të tyre për të hyrë në fuqinë punëtore ligjore. Shumica e pyetjeve të anketës shfrytëzojnë shkallën pesë pikëshe psikometrike të Likertit për matjen e besimeve dhe opinionëve të anketuesve për dinamikën e fuqisë punëtore në sektorin e drejtësisë. Hulumtimi gjithashtu përfshinë disa pyetje të hapura për të marrë të dhëna cilësore shtesë nga të anketuarit. Pyetësorët e plotë të anketës janë përfshirë në **Shtojca 2 (Studentët)** dhe në **Shtojcën 3 (Profesionistët)**.


Mjetet e kërkimit cilësor, duke përfshirë intervistat e informuesve kyç (IIK) dhe diskutimet me grupe të fokusuara (DGF), kanë plotësuar mbledhjen e të dhënave nëpërmjet pyetësorëve. IIK-të dhe DGF-të janë kryer duke përdorur pyetje dhe udhëzime të para-përcaktuara. Në prill-maj 2015, ekspertja ligjore e NCSC-së ka kryer gjithsej 15 IIK dhe gjashtë DGF. Një listë e plotë e intervistave dhe diskutimeve me grupe të fokusuara të kryera mund të gjenden në **Shtojcën 4**.

Mostra e anketës

Për Inicativën Hulomtuese për të Rinjtë dhe Femrat, NCSC ka marrë një total prej 156 përgjigjeve, duke përfshirë 94 femra dhe 58 meshkuj. 94 të anketuara femra, kanë përfshirë 62 studentë të juridikut, 13 avokatë, 7 gjyqtarë, 6 prokurorë, dhe 6 profesionistë të tjerë që punojnë në sektorin e drejtësisë (asistentë mësimdhënës, zyrtar ligjor dhe nëpunës të gjykatës). 58 të anketuarit meshkuj kanë përfshirë 35 studentë, 6 avokatë, 7 gjyqtarë, 6 prokurorë, dhe 4 profesionistë të tjerë që punojnë në sektorin e drejtësisë (profesorë, punonjës të OJQ-ve, administratorë të gjykatave). 4 të anketuar meshkuj nuk kanë specifikuar profesionin e tyre.

Figura 1: Mostra e anketës

Numri i përgjithshëm i të anketuarve 156 (Femrat 94, Meshkujt 58)



Anketa është zhvilluar në të shtatë rajonet e Kosovës — Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjilan, Mitrovicë, Ferizaj dhe Gjakovë — për të siguruar gjithë-përfshirje gjeografike.

Për të arritur një grup të llojllojshëm mostrash për Iniciativën Huluntuese për të Rinjtë dhe Femrat, ekspertja ligjore kryesisht ka përdorur kontaktet dhe listat e gjykatësve, avokatëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë që NCSC ka mbështetur gjatë 15 vjetëve të fundit. Deri tani, lista aktuale e femrave gjyqtare dhe prokurore nuk është në dispozicion në internet, por me mbështetjen e USAID/PJK, OAK-ja rifreskon listat e të gjithë avokatëve çdo vit. Gjithashtu, Oda e Noterëve të Kosovës mirëmban listën e publikuar me emrat e të gjithë noterëve në faqen zyrtare të saj.

Kufizimet e hulumtimit

Edhe me përfshirjen e të gjitha rajoneve të Kosovës, hulumtimi ende nuk mund të thuhet të jetë plotësisht përfaqësues për të gjithë vendin, pasi që nga disa rajone janë përfshirë vetëm disa të anketuar. Një tjetër kufizimi është përdorimi i teknikës së mostrimit me “snowball-top bore” në vend të mostrimit sipas rasteve për të synuar femrat gjyqtare, prokurore, profesionistët ligjor dhe studentët. Së fundi, derisa objektivi kryesor në popullatë për këtë hulumtim ishte rinia (meshkujt dhe femrat studente) dhe femrat profesioniste ligjore, një numër i konsiderueshëm i meshkujve profesionistë të anketuar kanë qenë po ashtu të angazhuar. Grupi i meshkujve profesionistë është përfshirë për të siguruar një pikë të rëndësishme të krahasimit për perceptimet dhe besimet lidhur me dinamikën e rinisë dhe gjinisë në sektorin e drejtësisë.

Grumbullimi i pyetësorëve të plotësuar ka qenë sfidë, pasi që të gjithë pyetësorët janë marrë fizikisht nga të anketuarit. Hulumtimi i ngjashëm mund të shpërndahej online me internet me përgjigjet e futura drejtpërsëdrejti në një bazë të dhënash online ose kanë mundur të mblidhen me telefon. Disa të anketuar kanë vënë në dukje se pyetësi i anketimit ishte tepër i gjatë dhe se ata do të preferonin një pyetësor më të shkurtër në anketimet në të ardhmen. Sfidë tjetër ishte se ky hulumtim është koordinuar si një hulumtim "me bazë në shtëpi" kundrejt atij "bazuar në zyrë" si projekt kërkimor, i cili ka krijuar disa komplikime logjistike, ku të gjitha janë tejkualuar nga ekspertja ligjore me ndihmën dhe përkushtimin e tri studenteve të juridikut.

Analiza e të gjeturave

Kjo pjesë paraqet një analizë të përgjigjeve të Iniciativës Huluntuese për të Rinjtë dhe Femrat dhe të dhëna kualitative të mbledhura në intervista dhe diskutime grimore.


Demografia

Profesioni: Të anketuarit përfshinin 64% studentë të juridikut dhe 36% profesionistë ligjor. Në mesin e të anketuarve profesionistë, 34% kanë qenë avokatë, 25% ishin gjyqtarë, 21% kanë qenë prokurorë, ndërsa 20% ishin profesionistë të tjerë që punojnë në sektorin e drejtësisë (asistentë mësimdhënës, zyrtarë ligjorë, bashkëpunëtorë profesional dhe nëpunës të gjykatave). **(Shiko figurën 2.)** Edhe pse gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë mund të anëtarësohen në shoqata profesionale, më pak se gjysma e të anketuarve kanë raportuar të jenë anëtarë të ndonjë shoqate profesionale. Ndër të anketuarit gjyqtarë dhe prokurorë, vetëm 26% kanë qenë anëtarë të një shoqate profesionale, ku 4 kanë qenë anëtarë të Shoqatës së Prokurorëve të Shtetit të Kosovës⁶ dhe 3 anëtarë të Forumit të Gjyqtareve dhe Prokurorëve⁷. Nuk ka pasur anëtarë të Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës në mesin e të anketuarve.

⁶ Për disa vite, Kryetare i Shoqatës së Prokurorëve të Shtetit ka qenë prokurore femër (Drita Hajdari Peci). Aktualisht Shoqata drejtohet nga një prokuror mashkull (Haxhi Derguti). Kjo informatë na është dhënë nga ish kryetarja, prokurorja Drita Hajdari Peci në qershor 2015.


⁷ Kryetarja e Bordit të Forumit të Gjyqtareve dhe Prokurorëve është gjyqtarja Biljana Rexhiq. Kjo informatë na është dhënë nga gjyqtarja Rexhiq në maj 2015.

Figura 2: Të anketuarit profesional sipas profesionit




Një e treta e të anketuarve studentë janë regjistruar në një program praktike. Në mesin e studentëve të regjistruar në praktikë, 42% kanë qenë në OAK (85% femra dhe 15% meshkuj) dhe 52% kanë qenë në gjykata (60% femra dhe 40% meshkuj). Në mesin e praktikantëve meshkuj, 70% janë regjistruar në gjykata. Më tej 3% e praktikantëve (të gjitha femra) janë regjistruar në Ministrinë e Drejtësisë, dhe 3% (të gjithë meshkuj) janë regjistruar në OJQ. **(Shiko figurën 3.)**

Figura 3: Regjistrimi i studentëve të juridikut në programet e praktikës



Mosha: Mosha e të anketuarve varion nga 18 deri në 60 vjeç. Shumica e të anketuarve ishin ndërmjet moshës 24 dhe 40 vjeç. Në mesin e studentëve të anketuar, 44% kanë qenë nën moshën 23 vjeç, dhe 37% të tjerë ishin ndërmjet 24 dhe 26 vjeç. Numri i përgjithshëm prej 3% të studentëve të anketuar kanë qenë mbi moshën 31 vjeç. Në mesin e të anketuarve profesionistë, 52% kanë qenë më të vjetër se 40 vjeç dhe 33% ishin ndërmjet 21 dhe 35 vjeç, me vetëm 13% nën moshën 30 vjeç. Nga të anketuarit profesionistë, 39% kanë qenë në profesionin ligjor për 10 deri 20 vite, dhe 27% kanë qenë në profesionin ligjor për 20 vjet apo më shumë. **(Shiko figurën 4.)**

Figura 4: Mosha e të anketuarve



Regjioni dhe shkolla juridike: Popullata e anketuar ka përfshirë të anketuar që jetojnë dhe punojnë në shtatë rajone të Kosovës. 51% e të anketuarve jetonin në Prishtinë, 12% në Gjakovë, 14% në Pejë, 10% në Mitrovicë, 5% në Gjilan, 4% në Ferizaj, dhe 4% në Prizren. Shumica e të anketuarve kanë diplomuar apo janë regjistruar në studime juridike në FJUP (71%). Pjesa tjetër e të anketuarve kanë vijuar fakultetin juridik në Kolegjin Iliria (14%), në Kolegjin AAB (8%), dhe në UPHZ (5%).

Statusi martesor dhe përgjegjësia familjare: Nga të gjithë të anketuarit 35% ishin të martuar, 63% kanë qenë të pamartuar, 2% ishin të ve, dhe më pak se 1% të shkurorëzuar apo të ndarë. Përqindja e lartë e të anketuarve të pamartuar mund të i atribuohet proporcionit të studentëve në mostrën e anketës, ndonëse 11% e studentëve ishin tashmë të martuar. Ndër profesionistët ligjor, 71% ishin të martuar.

Në mesin e 33% e të anketuarve të cilët i janë përgjigjur pyetjes për numrin e fëmijëve, 59% thanë se kishin një ose dy fëmijë. Në mesin e 49% të të anketuarve të cilët i janë përgjigjur pyetjes për personat për të cilët ata kujdesen, 47% thanë se ata kujdesen për fëmijët që jetojnë me ta, dhe 49% thanë se kujdesen për prindërit, prindërit e bashkëshortit/es, apo të afërm të tjerë.


48% e të gjithë të anketuarve konsiderojnë se meshkujt dhe femrat kanë të njëjtat përgjegjësi për kujdesin për fëmijë dhe familje, me 30% që janë përgjigjur jo, dhe 22% ishin të pavendosur. Edhe pse vetëm 11% e studentëve të anketuar aktualisht janë të martuar, perceptimi i tyre për rritjen e kërkesave për kujdesin e femrave ndaj fëmijëve dhe familjes ishte më i lartë sesa në mesin e profesionistëve të cilët kanë përvojë me balancimin e punës dhe obligimeve familjare. Ndërsa përqindjet e ngjashme të studentëve të anketuar (47%) dhe profesionistët e anketuar (50%) kanë vlerësuar se profesionistët ligjor meshkuj dhe femra të kenë të njëjtin kujdes ndaj fëmijëve dhe familjes, përqindja e të anketuarve që konsiderojnë këto përgjegjësi të jenë një barrë më e rëndë tek femrat profesioniste ishte më e lartë në mesin e studentëve (33%) sesa tek profesionistët (24%). Kur u është kërkuar të shpjegojnë, të anketuarit të cilët nuk u pajtuan se meshkujt dhe femrat kanë të njëjtën përgjegjësi familjare u shprehën se femrat kanë qenë më të përgjegjshme në kujdesin për familjen dhe më të përkushtuara ndaj familjes, derisa disa gjithashtu kanë thënë se niveli më i lartë i përgjegjesisë familjare për femrat ishte vetëm për shkak të

mentalitetit të vazhdueshëm se femrat duhej të ishin më përgjegjëse për familjen dhe fëmijët.

Motivimi dhe aspiratat

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se forca shtytëse për të studiuar juridikun dhe hyrjen në fuqinë punëtore ligjore ishte mbrojtja e drejtësisë dhe të drejtave. Në mesin e të anketuarve, 68% kanë dëshiruar të sigurojnë drejtësinë, 54% donin të ndryshojnë shoqërinë, dhe 48% dëshironin të dinë të drejtat e tyre ose mësojnë të tjerët për të drejtat e tyre. Derisa dëshira për të siguruar drejtësinë ishte e ngjashme në mesin e studentëve (68%) dhe profesionistëve (69%) të anketuar, të anketuarit më të rinj shprehën aspirata më të larta për të ndryshuar shoqërinë (58% në mesin e studentëve krahasuar me 47% në mesin e profesionistëve) ose se dinë dhe mësojnë të drejtat (56% në mesin e studentëve krahasuar me 31% në mesin e profesionistëve). Aspiratat për të ndryshuar shoqërinë nuk kanë shkuar aq larg sa të perceptohet një karrierë ligjore si pikë e hyrjes në karrierën politike, me vetëm 8% të studentëve dhe asnjë nga profesionistët e anketuar që raportojnë karrierën e ardhshme politike si një arsye për zgjedhjen e studimeve juridike. **(Shiko figurën 5.)**

Figura 5: Motivimi për ndjekjen e karrierës ligjore




Totali prej 27% të anketuarve profesionistë vunë në dukje se ata kanë zgjedhur studimet juridike për prestigj dhe për statusin e profesioneve. Të anketuarit profesionistë po ashtu e kanë parë veten në profesionin e tyre për një periudhë afatgjatë, me 85% që raportojnë se ata duan të qëndrojnë në profesionin ligjor për më shumë se 10 vite. Për krahasim, studentët kanë shprehur qëllime më afatshkurtra, me 71%, që duan të qëndrojnë në profesionin ligjor për pesë vitet e ardhshme. Përgjigjet e studentëve kanë shprehur një perceptim të pasigurisë në lidhje me atë se cilën karrierë të zgjedhin dhe si të ndërmarrin hapa për të hyrë në një karrierë ligjore, e cila mund të çojë studentët tek rruga "më e lehtë" ose tek rruga e perceptuar si më e qasshme sesa rruga e tyre e preferuar.

34% e të anketuarve profesionistë raportuan që punojnë si avokatë, 25% ishin gjyqtarë dhe 21% prokurorë. Studentët e regjistruar në praktikë janë regjistruar në numër më të lartë në gjykata (52%)

sesa me avokatë (42%). Nëpërmjet këtij studimi, nga anketa dhe DGF-të është e qartë se shumica e studentëve ishin të interesuar për fillimin e karrierës së tyre në gjykata, por jo domosdoshmërisht kanë synuar të qëndrojnë në gjykata për kohëzgjatjen e plotë të karrierës së tyre profesionale. Studentët e anketuar kanë perceptuar se dëshirojnë profesionet si në vijim, gjyqtarit (34%), avokatit (28%), dhe noterisë/përmbauesit privat (19%) si më tërheqëset ndër profesionet e fuqisë punëtore ligjore. Perceptimet e profesionit më atraktiv dallonin ndjeshëm midis të rinjve meshkuj dhe femra, studentet e juridikut femra preferonin më shumë profesionin e gjyqtares (40%) sesa të avokates (27%), dhe studentët e juridikut meshkuj preferonin profesionin e avokatit (31%) apo noterit/përmbauesit privat (28%) mbi atë të gjyqtarit (21%). Kur janë pyetur se çfarë profesioni do të fillojnë pas diplomimit, meshkujt e anketuar janë shprehur në nivel të barabartë për profesionin e gjyqtarit dhe avokatit (23% secili), dhe të anketuarat femra treguan një proporcion më të lartë për avokate (36%) sesa për gjyqtare (28%) përkundër preferencës së tyre të shprehur për profesionin e gjyqtares. **(Shiko figurën 6.)**

Figura 6: Krahasimi i aspiratave dhe planeve për karrierë në mesin e studentëve të juridikut



Dinamika e rinisë dhe gjinisë në shoqëri

Ka ekzistuar konsensus në mesin e të anketuarve se femrat që punojnë në sektorin e drejtësisë vlerësohen dhe respektohen. Të gjithë të anketuarit profesionistë (99%) janë pajtuar apo pajtuar fuqimisht se vendimet nga gjyqtarët meshkuj dhe femra mbështeten dhe zbatohen me respektin e njëjtë. 80% e të gjithë të anketuarve janë pajtuar fuqimisht se femrat që punojnë në sektorin e drejtësisë si gjyqtare ose avokate vlerësohen dhe respektohen. Derisa perceptimet ishin në përputhje ndërmjet të rinjve dhe profesionistëve sa i përket respektit për avokatët, profesionistët kanë një perceptim më pozitiv për respektin për femrat gjyqtare sesa studentët. 78% e studentëve të rinj dhe 76% e profesionistëve konsiderojnë se femrat avokate respektohen mjaft shumë. Si kontrast, 79% e studentëve të rinj kanë vlerësuar gjyqtaret femra të jenë tejet të respektuara krahasuar me 87% të profesionistëve. Asnjë i anketuar profesionist nuk ka vlerësuar se femrat gjyqtare nuk respektohen. Përgjigjet kanë vënë në pah një diferencë ndërmjet perceptimit dhe përvojës dhe tregojnë shqetësim për trajtim të barabartë në mesin e të rinjve. Këto shqetësime do të mund të adresoheshin lehtë përmes rritjes së bashkëpunimit me profesionistët.

Perceptimet e respektit për femrat gjyqtare dhe avokate kanë qenë konsistente për gjininë tek të anketuarit e rinj. Në mesin e profesionistëve, meshkujt kanë shprehur shqetësim më të madh lidhur me respektin e barabartë për avokatet femra sesa homologet e tyre femra, me 14% të të anketuarve meshkuj që nuk pajtoheshin krahasuar me 4% të të anketuarve femra që nuk pajtoheshin. Duke komentuar mbi përgjigjet e tyre, femrat profesioniste kanë vënë në dukje se avokatet femra respektohen kur ato punojnë shumë dhe kanë theksuar edhe përvojën e tyre. Megjithatë një i anketuar mashkull ka

komentuar se numri i ulët i femrave avokate tregon se respekt është ende i ulët.

Pranimi dhe mbështetja nga familja dhe komuniteti për ato që zgjedhin të hyjnë në fuqi punëtore ligjore në përgjithësi ka qenë e lartë, por dallime të rëndësishme janë të dukshme në bazë të rinisë dhe gjinisë. Shumica e të anketuarve (73%) gjithashtu janë pajtuar se meshkujt dhe femrat që hyjnë në arsimimin ligjor trajtohen njëjtë nga familjet e tyre ose komuniteti, por 16% nuk pajtohen me këtë. Trajtimi i perceptuar i pabarabartë nga familja dhe komunitet është i njëtrajtshëm për gjini dhe të rinjtë. Në mesin e profesionistëve, janë regjistruar dallime të mëdha midis meshkujve dhe femrave, ku 20% e të anketuarve femra nuk janë pajtuar se pranimi nga familja dhe komuniteti për zgjedhjen e karrierës profesionale është i njëjtë, krahasuar me 9% në mesin e kolegëve të tyre meshkuj. Pjesëmarrësit në punën me IIK dhe DGF janë shprehur se femrat ndonjëherë nuk trajtohen nga komuniteti në mënyrë të njëjtë dhe se ekziston perceptimi se femrat janë më të ndjeshme dhe nuk do të jenë në gjendje të marrin vendime "të rënda" që ato mund të duhet të marrin si avokate, gjyqtare ose prokurore. Pjesëmarrësit gjithashtu kanë komentuar se femrat, për shkak të përgjegjësisë për kujdesin për familje dhe kujdesin për fëmijë, mund të mos kenë zhvillimin profesional dhe duhet të punojë shumë më shumë se sa meshkujt për të qenë të suksesshme në karrierën e tyre ligjore.

Dinamika e rinisë dhe gjinisë në arsimimin ligjor

Shumica e të anketuarve kanë perceptuar se ekziston qasje e barabartë, mundësi të barabarta dhe barazi gjinore në arsimimin ligjor.

Të anketuarit janë pajtuar se meshkujt dhe femrat kanë qasje të barabarta në arsimin ligjor. Nga të gjithë të anketuarit, 86% ose janë pajtuar fuqimisht, 6% as janë pajtuar apo nuk janë pajtuar, dhe 8% nuk janë pajtuar apo nuk janë pajtuar fuqimisht. Rinia duket të ketë më shumë qëndrime optimiste për qasje të barabartë me vetëm 5% që nuk pajtohen në krahasim me 13% të profesionistëve. Kjo tregon se barazia gjinore në qasjen në arsimimin ligjor është përmirësuar me kalimin e kohës, duke pasur parasysh përvojën më të fundit të të rinjve të anketuar. Nga të rinjtë e anketuar, shumica po ashtu janë pajtuar se studentët meshkuj dhe femra kanë marrë trajtim të barabartë në klasë dhe mundësi për pjesëmarrje, dhe 83% kanë thënë se ata kanë marrë pjesë shpesh në klasë dhe 82% janë ndjerë rehat që marrin pjesë pavarësisht nga gjinia e instruktorit apo profesorit. Femrat e intervistuar kanë raportuar pjesëmarrjen pak më të lartë se sa homologët e tyre meshkuj.

Më shumë se 90% e të anketuarve janë pajtuar se profesionistët meshkuj dhe femra në fuqinë punëtore ligjore kanë arsim ekuivalent formal në nivelin universitar dhe se studentët janë të përgatitur mirë për ushtrimin e profesionit ligjor pas diplomimit. Në mesin e të anketuarve profesionistë, 95% kanë thënë se kanë pasur përvojë pozitive që kanë studiuar ligjin dhe se ata ndjehen të përgatitur profesionalisht për ushtrimin e profesionit pas studimeve ligjore, ndërsa më pak se 2% kanë thënë se ata nuk ndjehen të përgatitur. Ndërsa më shumë se sa dy herë numri i studentëve janë ndjerë të papërgatitur për ushtrimin e ligjit pas studimeve të tyre ligjore, ata kanë raportuar nivele të larta të kënaqësisë dhe gatishmërisë si rezultat i studimit të juridikut, sikurse gjeneratat e mëparshme që tani janë profesionistë, ndërsa 90% e studentëve raportuan se kishin një përvojë pozitive në fakultetin e drejtësisë dhe janë ndjerë të përgatitura për të hyrë në fuqinë punëtore ligjore. **(Shiko figurën 7.)**

Figura 7: Niveli i përgatitjes për fuqinë punëtore pas diplomimit



Pavarësisht nga përqindja e lartë e studentëve që raportojnë se ata ndjehen të përgatitur profesionalisht për ushtrimin e profesionit ligjor pas diplomimit, 4% kanë raportuar se ndihen të përgatitur dhe 5% shprehën pasiguri. Të dhëna kualitative nga IIK dhe DGF me profesionistët dhe studentët e juridikut tregojnë se mungon përvoja praktike e të rinjve për të ndërtuar besimin e tyre për të hyrë në fuqinë punëtore dhe për përcaktimin e një rruge të karrierës. Ndërsa lëndët e orientuara drejt praktikës tani janë gjithnjë e më shumë në dispozicion si pjesë e përvojës arsimore përmes klinikave ligjore dhe paneleve profesionale, ofertat e këtyre paneleve⁸ mbeten të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat praktike të studentëve dhe mundësi më të mëdha janë të domosdoshme për një mjedis të fuqisë punëtore nëpërmjet punës praktike, panairit e karrierës dhe rrjetet formale dhe joformale mes studentëve dhe profesionistëve. Për më tepër, kur janë pyetur nëse meshkujt dhe femrat profesionistë ligjor kanë njohuri adekuate, shkathësitë adekuate, dhe trajnime për ushtrimin e profesionit me përfundimin e arsimimit ligjor, 16% e të anketuarve profesionistë nuk janë pajtuar apo nuk janë pajtuar fuqishëm. Këto të dhëna kontradiktore janë një shembull i një fushe ku ka një mospërputhje ndërmjet perceptimit dhe përvojës.

Studentët e anketuar kanë treguar se raporti i profesorëve meshkuj me femra ishte 60-40. Për profesorët meshkuj dhe femra në juridik që ofrojnë nivelin dhe cilësinë e njëjtë të mësimdhënies, më shumë se gjysma e studenteve femra (54%) pajtohen fuqimisht apo thjeshtë pajtohen se profesorët meshkuj dhe femra në juridik ofrojnë të njëjtin nivel dhe cilësi të mësimdhënies në krahasim me 28% meshkuj studentë të anketuar.

Dinamika e rinisë dhe gjinisë në fuqinë punëtore

Në përgjigje për pjesëmarrjen e femrave në fuqinë punëtore, të anketuarit konsiderojnë se numri është i drejtë në arsimimin ligjor dhe tek prokurorët, por shumë i ulët tek gjyqtarët dhe avokatët. Këto perceptime ndërlidhen me nën-përfaqësimin kritik të femrave në profesionet kryesore të sektorit të drejtësisë, siç vërtetohet nga të dhënat e mbledhura nga OAK, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës. Kombinuar me perceptimet e pabarazisë së gjinive të përshkruara më tej në këtë raport, ka shqetësime se nivelet e ulëta mund të veprojnë për t'i bindur femrat e reja që të mos marrin në konsideratë profesionet që po plaken dhe dominohen kryesisht nga meshkujt.

Perceptimet e barazisë gjinore në fuqinë punëtore dallon ndërmjet profesioneve dhe midis të anketuarve. **(Shiko figurat 8-10.)** Të anketuarit profesionistë dhe të rinj kanë perceptime të ndryshme

⁸ Në FJUP, rritja e disponueshmërisë të lëndëve klinike ka mundësuar që universiteti të ofrojë mësimdhënie të orientuar në praktikë një numri të studentëve në rritje çdo vit, nga 10 studentë që përfitojnë nga kurset e tilla në nivelin master në vitin akademik 2011-2012 dhe pothuajse 180 studentë që përfitojnë çdo vit në vitet akademike 2013-2014 dhe 2014-2015.

me një perceptim më të lartë të barazisë në arsimimin ligjor në mesin e studentëve sesa në mesin e profesionistëve. Në mesin e studentëve, 70% kanë vlerësuar se pjesëmarrja e femrave në fakultetin juridik të jetë e mjaftueshme në krahasim me 62% të profesionistëve. Një numër i vogël, megjithatë mjaft i rëndësishëm i të rinjve të anketuar (20%) madje edhe kanë raportuar se përfaqësimi i femrave në mesin e profesorëve ishte shumë i lartë, i cili ishte dy herë më shumë se të anketuarit profesionistë.

Më shumë femra profesioniste kanë vlerësuar se numri i femrave prokurore dhe gjyqtare të jetë i mjaftueshëm krahasuar me kolegët e tyre meshkuj. Kjo mund të tregojë një ndërgjegjësim në rritje për nevojën për barazi gjinore në profesionet ligjore midis profesionistëve meshkuj dhe se meshkujt do të ishin aleatë të fortë për përpjekjet për të tërhequr më shumë femra në fuqinë punëtore ligjore. Ngjashëm, tek rinia e anketuar, 55% e studentëve meshkuj konsiderojnë se numri i gjyqtarëve femra ishte tepër i ulët krahasuar me 45% e homologëve të tyre femra.

Figura 8: Numri i profesionistëve është "mjaftueshëm"

	Profesorët e juridikut	Avokatë	Prokurore	Gjyqtarë
Studentë meshkuj	71%	28%	44%	38%
Studente femra	69%	20%	40%	36%
Profesionistë meshkuj	64%	14%	33%	30%
Profesioniste femra	62%	21%	50%	43%

Figura 9: Numri i profesionistëve është "shumë i ulët"

	Profesorët e juridikut	Avokatë	Prokurore	Gjykatës
Studentë meshkuj	9%	66%	41%	55%
Studente femra	5%	70%	40%	45%
Profesionistë meshkuj	9%	71%	52%	55%
Profesioniste femra	8%	75%	45%	43%

Figura 10: Numri i profesionistëve është "shumë i lartë"

	Profesorët e juridikut	Avokatë	Prokurore	Gjykatës
Studentë meshkuj	18%	6%	4%	7%
Studente femra	21%	3%	5%	5%
Profesionistë meshkuj	4%	0%	0%	0%
Profesioniste femra	8%	0%	0%	0%

Dinamika e rinisë dhe gjinisë në vendin e punës ndër profesionistë

Në fushat kryesore, shumica e të anketuarve kanë perceptuar se ekziston barazi gjinore në sektorin e drejtësisë dhe në fuqinë punëtore ligjore.

Perceptimi i profesionistëve dhe përvoja në punë


Nivelet e larta të barazisë janë perceptuar në mundësitë e karrierës në nivelin e hyrjes dhe për avancim në mesin e profesionistëve. Të anketuarit po ashtu kanë raportuar se nuk ka diskriminim në paga. Të anketuarit meshkuj dhe femra janë pajtuar se meshkujt dhe femrat kanë të njëjtat mundësi profesionale me 70% të të anketuarve profesionistë që fuqimisht pajtohen apo thjeshtë pajtohen se mundësitë e punës janë në dispozicion në nivel të barabartë dhe 78% fuqimisht pajtohen apo pajtohen se perspektiva e avancimit është në dispozicion në nivel të barabartë. Kur janë pyetur në mënyrë specifike për përzgjedhjen e gjyqtarëve të rinj, 70% u pajtuan se femrat dhe meshkujt trajtohen në mënyrë të barabartë.

Derisa meshkujt dhe femrat profesioniste u shprehën për pajtimin se mundësitë e punësimit janë në dispozicion në mënyrë të barabartë për meshkuj dhe femra në përqindje të ngjashme, niveli i mospajtimit

ishite më i lartë tek të anketuarat femra, me 24 për qind për femrat kundrejt 18 për qind në mesin e të anketuarve meshkuj. Nga të dhënat kualitative të mbledhura nëpërmjet IIK-ve dhe DFG-ve, disa nga femrat e anketuara kanë thënë se meshkujt janë dominues dhe kanë më shumë privilegje dhe mundësi që u jepen atyre. Në anën tjetër, meshkujt e anketuar kanë thënë se ekziston diskriminim pozitiv për femrat dhe disa kanë thënë se meshkujt dhe femrat janë të barabartë në punësim por jo në avancimin.

Lidhur me avancimin, perceptimet e pabarazive janë rritur sa u përket avancimeve aktuale krahasuar me disponueshmërinë e mundësive. Në pyetjen nëse meshkujt dhe femrat profesionistë ligjor gradohen dhe transferohen në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, vetëm 62% janë pajtuar, krahasuar me 70 % që besojnë se mundësitë për avancim janë në dispozicion në mënyrë të barabartë. Kjo thekson një dallim ndërmjet perceptimit dhe përvojës pasi që mundësitë mund të jenë në dispozicion në mënyrë të barabartë mirëpo sigurimi i tyre mbetet jashtë mbulimit të profesionisteve femra. Dallimet në opinion ishin më të mëdha kur shikojmë të anketuarit që konsiderojnë se gradimet aktuale u jepen në mënyrë të pabarabartë meshkujve dhe femrave profesioniste me perceptimin e pabarazisë tri herë më të lartë në mesin e të anketuarve femra (29%) krahasuar me meshkujt e anketuar (10%). **(Shiko figurën 11.)**

Figura 11: Perspektiva e avancimit



Të anketuarit po ashtu besojnë se barazia gjinore mungon në procesin e vendimmarrjes dhe në rolin e udhëheqjes në sektorin e drejtësisë. Në mesin e të anketuarve profesionistë, 25% nuk janë pajtuar se meshkujt dhe femrat profesionistë ligjor marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrje në institucionet e sektorit të drejtësisë dhe kanë qasje të barabartë në rolet e udhëheqjes në shoqatat profesionale. Niveli i mospajtimeve ka qenë më i madh në mesin e femrave me 34% të të anketuarve femra që kanë raportuar pabarazi krahasuar me 20% të meshkujve të anketuar. Të dhëna kualitative të mbledhura gjatë IIK-ve tregojnë se megjithëse ekzistojnë mundësitë për pjesëmarrje për femrat, ka më pak mundësi për udhëheqje, dhe meshkujt dëshirojnë të udhëheqin vet. Për shembull, një avokate ka thënë se Këshilli Drejtues i OAK-së nuk ka ndonjë anëtare femër dhe rrjedhimisht nuk ka ndonjë femër që është kryetare e degëve rajonale të OAK-së.⁹ Të intervistuarit kanë pohuar se femrat inkurajohen të marrin pjesë, por që kur ngritën çështje të udhëheqjes, meshkujt dëshirojnë të marrin kontrollin.

Perceptimi i të rinjve dhe përvoja në punë

Për të krahasuar perceptimet e të rinjve dhe profesionistëve për dinamikën në vendin e punës, të anketuarit e rinj janë pyetur rreth një situatë të krahasueshme me punësimin: një praktikë. Studentët dhe profesionistët kanë perceptime të ngjashme për qasjen, barazinë dhe profesionalizmin. Shumica e të anketuarve studentë janë dakord se meshkujt dhe femrat kanë qasje të barabartë në mundësitë e

⁹ Të gjithë kryetarët e degëve rajonale të OAK-së janë anëtarë të Bordit Drejtues të OAK-së.

praktikës, rekrutohen njësoj dhe marrin vëmendjen e barabartë, mundësinë për të marrë pjesë dhe për përvojë praktike në programet e tyre të praktikës. Në mesin e të gjithë të anketuarve studentë, 88% janë pajtuar fuqimisht apo janë pajtuar se meshkujt dhe femrat kanë të njëjtat mundësi për praktikë në sektorin e drejtësisë dhe 73% fuqimisht pajtohen ose pajtohen se ata trajtohen në mënyrë të barabartë në vendin e punës.

Perceptimet e barazisë ishin më të larta në mesin e studentëve meshkuj, me 97% që konsideronin se ekziston qasje e barabar në mundësitë e praktikës dhe 83% që konsiderojnë se ekziston trajtim i barabartë në vendet e punës. Krahasimisht, 82% e studenteve femra kanë perceptuar se ka qasje të barabartë dhe 66% kanë perceptuar trajtim të barabartë. Një e anketuar femër ka komentuar se "ne kemi të drejta të barabarta, por nuk trajtohemi njëjtë." Përveç kësaj, kur janë pyetur për përvojën e tyre të rekrutimit, 73% e të anketuarve meshkuj kanë konsideruar se praktikantët meshkuj dhe femra rekrutohen njësoj krahasuar me 63% e të anketuarve femra që pajtohen.

Perceptimet e mundësive dhe përvojës praktike ishin njëloj pozitive dhe në përputhje ndërmjet të anketuarve meshkuj dhe femra. Të gjithë të anketuarit studentë, 73% janë pajtuar fuqimisht apo janë pajtuar se meshkujt dhe femrat praktikante kanë qasje të barabartë në përvojën praktike. Kjo tregon se përvojat e praktikës janë më pozitive sesa perceptimet. Kjo më tutje përforcohet nga të dhënat e mbledhura ndërmjet 2012 dhe 2015 nga NCSC në dy universitete. Të dhënat treguan se studentet femra janë regjistruar në punën praktike në numra më të lartë (60%) sesa homologët e tyre meshkuj (40%). Ngjashëm, demografia e anketës ka treguar një përqindje më të lartë të praktikës aktuale në mesin e femrave të anketuara (40%) sesa në mesin e të anketuarve meshkuj (34%).

Studentët e anketuar kanë perceptuar profesionet e gjyqtarit (34%) dhe avokatit (28%) si më tërheqëset për të diplomuarit në drejtësi. Perceptimet e barazisë në aspektin e punësimit dhe avancimit ishin më të ulëta në mesin e të rinjve sesa në mesin e profesionistëve, me përafërsisht 60% të studentëve (në krahasim me 70% të profesionistëve) duke vlerësuar se perspektivat për punësim dhe avancim janë të barabarta. Perceptimet e pabarazive ishin edhe më të mëdha në mesin e studenteve femra. Kur janë pyetur nëse perspektivat e punësimit dhe avancimit ishin të barabarta, 21% e të anketuarve femra nuk u pajtuan në krahasim me 14% të të anketuarve meshkuj. Kjo tregon një shkallë të lartë të pesimizmit në mesin e studenteve femra para hyrjes në fuqinë punëtore ligjore. Ky pesimizëm mund ta forcojë edhe më tej nivelin e ulët të përfaqësimit të femrave në fuqinë punëtore ligjore, pasi që femrat thjeshtë mund të mos përpiqen të i bashkohen profesionit për shkak të një pritshmërie për mundësi të pabarabarta.

Perceptimet e respektit dhe aftësive për të kryer punën

Përkundër shqetësimeve lidhur me barazinë në perspektivën e karrierës dhe vlerësimit për avancimin, shumica e të anketuarve kanë perceptuar se profesionistët ligjore femra respektohen shumë. Në mesin e profesionistëve, 87% kanë thënë se femrat që zgjedhin të punojnë në sektorin e drejtësisë si gjyqtare respektohen mjaft shumë, dhe 76% thanë se femrat që zgjedhin të punojnë në sektorin e drejtësisë si avokate respektohen mjaft shumë. Perceptimet e ngjashme janë regjistruar në mesin e të rinjve, me 79% që vlerësojnë se femrat gjyqtare respektohen mjaft shumë dhe 78% vlerësojnë se femrat avokate respektohen mjaft shumë.

Të anketuarit profesionistë besonin se nuk ka ndonjë pabarazi të rëndësishme në qasjen e tyre tek klientët apo aftësitë e tyre për të kryer punën e tyre para organeve gjyqësore apo administrative dhe se femrat dhe meshkujt marrin trajtim të barabartë kur paraqiten në gjykatë si gjykatëse, prokurore, ose avokate. Pothuajse të gjithë të anketuarit profesionistë (98%) kanë theksuar se nuk ka diskriminim në qasjen ndaj klientëve. Ngjashëm, 91% e të anketuarve profesionistë janë pajtuar se meshkujt dhe femrat avokate gëzojnë të njëjtat të drejta për të dalë para organeve gjyqësore apo administrative dhe trajtohen si të barabartë. Ndonëse të dy grupet, meshkujt dhe femrat u pajtuan se ata trajtohen në mënyrë të


barabartë nga organet gjyqësore dhe administrative, 8% e të anketuarve nuk u pajtuan femra në krahasim me asnjë nga homologët e tyre meshkuj.

Sfidat e vazhdueshme

Edhe pse të anketuarit kanë pranuar se ka shumë mundësi për të diplomuarat në juridik, avokatet dhe gjyqtaret, ato kanë ndjerë se vazhdojnë të ekzistojnë sfida për femrat në fuqinë punëtore ligjore. Të anketuarit profesionistë kanë vlerësuar se profesionistët femra përballen me pengesa dhe se këto pengesa ndikojnë tek femrat avokate më shumë sesa tek ato gjyqtare. Përqindja e të anketuarve vlerësojnë femrat profesioniste për të jenë të lira pa pengesa ishte 56% për femrat që punojnë si gjyqtare krahasuar me 49% për femrat që punojnë si avokate. Perceptimet e pengesave ishin dukshëm më të larta tek të anketuarat femra, me 50% që vlerësonin se gjyqtaret femra nuk përballen me pengesa në krahasim me 82% e meshkujve të anketuar dhe me 25% që vlerësojnë se avokatet femra nuk përballen me pengesa në krahasim me 77% të të anketuarve meshkuj. Të anketuarit e rinj kanë madje një pikëpamje edhe më pesimiste për sfidat që i presin ata në fuqinë punëtore ligjore, me vetëm 24% të studentëve që nuk janë pajtuar se femrat përballen me pengesa si gjyqtare dhe 29%, që nuk pajtohen se ato hasin pengesa si avokate. **(Shiko figurën 12.)**

Figura 12: Perceptimet e sfidave për femrat në fuqinë punëtore ligjore

Femrat që punojnë në sektorin e drejtësisë nuk hasin në pengesa




Pengesat e perceptuara përfshijnë pritjet shoqërore, mentalitetin dhe paragjykimet, opinionin publik, mungesën e besimit të publikut tek femrat, mungesën e roleve të udhëheqjes për femrat, dhe mungesa e vetëbesimit tek vetë femrat. Të anketuarit kanë pranuar se femrat ndeshen me një sërë pritjesh tjera, me 16% e të gjithë të anketuarve që nuk pajtohen se meshkujt dhe femrat që hyjnë në arsimimin dhe profesionin ligjor trajtohen në të njëjtën mënyrë nga familje e tyre dhe komuniteti.

Raporti më i lartë i studentëve që besojnë se femrat përballen me pengesa si gjyqtare është i lartë kur merret parasysh se studentët shohin më shumë mundësi për një karrierë profesionale si gjykatës sesa si avokat dhe se të anketuarit kanë nivel më të lartë mospajtimi për femrat që punojnë si avokate. Kjo tregon një dallim ndërmjet perceptimeve të njerëzve "para-punës" dhe "në punë", dhe dallimin në mes të perceptimit dhe përvojës, pasi që në parim profesionistët mund të ndikohen nga përvoja e vet atyre. Ndërsa shumica e studentëve fuqimisht pajtohen se meshkujt dhe femrat kanë qasje të barabartë në arsimimin ligjor, se femrat që punojnë në sektorin e drejtësisë respektohen dhe vlerësohen, dhe se ka mundësi të barabarta për meshkuj dhe femra në sektorin e drejtësisë, një përqindje të lartë ende

perceptojnë se ekzistojnë pengesa për barazi.

Paragjykimi gjinor në mesin e klientëve është vërejtur gjithashtu, me 28% të të anketuarve që thonë se palët në një gjykim preferojnë gjyqtarë meshkuj (por 25% e të anketuarve femra nuk janë pajtuar me këtë deklaratë) dhe 32% që thonë se palët e dëmtuara dhe klientët që kërkojnë përfaqësim ligjor preferojnë prokurorë apo avokatët mbrojtës të jenë meshkuj (por këtu edhe 20% e femrave nuk pajtohen me këtë deklaratë). **(Shiko figurën 13.)** Në IJK, disa femra janë shprehur se klientët nganjëherë kanë preferencë për meshkuj, veçanërisht kur ato kanë qenë femra të reja në fillim të karrierës së tyre ligjore, por shumë prej tyre kanë parë një ndryshim përgjatë viteve. Të tjerë të anketuar po ashtu kanë thënë se ndonjëherë klientët preferojnë avokate dhe gjyqtare femra, dhe gjithashtu është cekur se perceptimi publik ndaj femrave profesioniste po ndryshon pozitivisht.

Figura 13: Preferencat e nxitura nga gjinia në mesin e palëve dhe klientëve



Diskriminimi dhe ngacmimet

Pjesëmarrësit e anketuar kanë ndjerë se meshkujt dhe femrat marrin trajtim të barabartë në vendin e punës. Pothuajse të gjithë (90%) e të anketuarve meshkuj dhe femra kanë vlerësuar se meshkujt dhe femrat marrin trajtim dhe mundësi të barabarta për të marrë pjesë në vendin e punës. Derisa më shumë se gjysma e të anketuarve profesionistë (68%) janë pajtuar fuqimisht apo janë pajtuar që mjedisi i tyre i punës është apo ka qenë pa ngacmime dhe armiqësi ndaj femrave, 25% nuk janë pajtuar. Në mesin e studentëve të anketuar (73%) janë pajtuar fuqimisht apo janë pajtuar që mjedisi i tyre i mësimit apo klasa ka qenë pa ngacmime dhe armiqësi ndaj femrave, derisa 18% nuk janë pajtuar. Nivelet e mospajtimeve kanë qenë të ngjashme në mesin e profesionistëve (25%, duke mos qenë dakord që vendet e tyre të punës janë pa ndonjë ngacmim) dhe studentët (18%, duke mos u pajtuar që në klasat e tyre nuk ka ngacmime). Shumica e të anketuarve (62%) kanë raportuar se ata kurrë nuk kanë përjetuar apo dëshmuar për komente fyese ose ofenduese në bazë të seksit apo gjinisë.

Ngjashmëritë dhe dallimet në profesione

Kur krahasohen përgjigjet në profesione të ndryshme brenda fuqisë punëtore ligjore, është e qartë se perceptimi i barazisë gjinore për respektin, mundësitë dhe trajtimin është shumë më i lartë tek gjyqtaret femra sesa tek profesionet tjera. Përgjigjet e femrave gjyqtare kanë qenë në mënyrë të përputhshme më

të larta në afirmimin e barazisë gjinore në sektorin e drejtësisë sesa përgjigja mesatare nga popullsia e përgjithshme. Po kështu, grupi i profesionistëve që demonstuan perceptimin më të lartë për pabarazinë gjinore ishin avokatët. **(Shiko figurën 14.)**

Figura 14: Perceptimet e kundërta për vendin e punës në mesin e femrave gjyqtare dhe avokate¹⁰

Pajtohem se...	Të gjithë profesionistët	Gjyqtaret femra	Avokatet femra
Meshkujt dhe femrat marrin kompensim/page të barabarta	100%	100%	100%
Vendimet e gjyqtarëve meshkuj dhe femra mbështeten me respekt të barabartë	98%	100%	100%
Meshkujt dhe femrat trajtohen në mënyrë të barabartë në vendin e punës	91%	100%	85%
Meshkujt dhe femrat kanë mundësi të barabarta për avancimin	78%	86%	77%
Meshkujt dhe femrat kanë të njëjtat mundësi punësimi	70%	71%	58%

Kjo ofron një kontrast interesant për atë se si femrat gjyqtare perceptojnë përvojat e tyre me paragjykimet gjinore, kundrejt këndvështrimit të profesionisteve tjera ligjore dhe rinisë. Ky kontrast në përgjigjet nga gjyqtaret femra tregon se ka më pak paragjykim gjinor dhe pabarazi gjinore në gjyqësor sesa në profesione të tjera ligjore. Kjo po ashtu konfirmohet edhe në perceptimet e sfidave që prekin femrat profesioniste. **(Shiko figurën 15.)**

Figura 13: Perceptimet e kundërta për sfidat në mesin e femrave gjyqtare dhe avokate¹¹

Nuk pajtohem se...	Të gjithë profesionistët	Gjyqtaret femra	Avokatet femra
Femrat gjyqtare përballen me pengesa në profesionin e tyre	45%	78%	27%
Femrat avokate përballen me pengesa në profesionin e tyre	43%	61%	33%

Perspektivat e rinisë dhe ato gjinore ndaj faktorëve për sukses në fuqinë punëtore ligjore

Nevoja e vazhdueshme për zhvillimin e mëtejshëm profesional dhe për trajnim ka qenë një gjetje kyçe në Iniciativën Hulumtuese për të Rinjtë dhe Femrat.

Shumica e të anketuarve janë pajtuar se meshkujt dhe femrat kanë qasje të barabarta në arsimimin ligjor. Në mesin e të anketuarve profesionistë, 60% raportuan se kanë marrë pjesë në më shumë se 15 kurse të trajnimit të vazhdueshëm ligjor apo gjyqësor që nga fillimi i karrierës së tyre dhe 85% pajtohen fuqimisht apo pajtohen se ekzistojnë qasje të barabarta në mundësitë e trajnimit. 9% kanë raportuar se kanë marrë pjesë në 11-15 kurse dhe 16% në 3-5 kurse. Temat që më së shpeshti theksohen në anketë si fusha me interes për vazhdimin e arsimimit ligjor ishin: (1) E drejta penale, veçanërisht krimet komplekse siç është krimi i organizuar, terrorizmi dhe krimet e luftës; (2) menaxhimi i gjykatave, (3) e drejta ndërkombëtare, e drejta ekonomike dhe arbitrazhi; (4) drejtësia për të mitur; (5) zbatimi i ligjeve të reja të miratuara, dhe (6) intervistimi i klientit dhe trajnimi për profesorët për marrëdhëniet profesor-student. Të gjitha këto tema korrespondojnë me fusha të reja apo në zhvillim të legjislationit në kuadër


¹⁰ Avokatet femra përfshijnë avokatet mbrojtëse (p.sh. avokatet e licencuara në OAK) dhe avokatet që ofrojnë ndihmën juridike falas.

¹¹ Avokatet femra përfshijnë avokatet mbrojtëse (p.sh. avokatet e licencuara në OAK) dhe avokatet që ofrojnë ndihmën juridike falas.

të sektorit të drejtësisë në Kosovë.

Në pyetjen lidhur me atë se çfarë ishte e nevojshme për të arritur sukses në karrierën e tyre (me shumë zgjedhje), 91% e të anketuarve kanë thënë mundësitë për zhvillimin profesional/arsimimin e vazhdueshëm, 42% kanë thënë rritja e barazisë gjinore në vendin e punës, dhe 32% kanë thënë mentorimi. Një analizë e përgjigjeve të meshkujve dhe femrave ka treguar se këto përgjigje kanë qenë vazhdimisht më të larta në mesin e studentëve meshkuj me 97% të anketuarve meshkuj që lidhin mundësitë e zhvillimit profesional/arsimimit të vazhdueshëm për sukses në krahasim me 87% të studenteve femra. Studentet femra po ashtu janë përgjigjur se kontributi i mentorimit dhe i barazisë gjinore në vendin e punës do të ndihmonte suksesin e tyre profesional në përqindje më të ulët sesa studentët meshkuj: 27% (femra) krahasuar me 42% (meshkuj) për mentorimin dhe 42% (femra) krahasuar me 45% (meshkuj) për barazi gjinore në vendin e punës. Vetëm 2% e studenteve femra kanë raportuar qasjen në kujdesin për fëmijë si të nevojshme për të pasur sukses, krahasuar me 33% të homologëve të tyre meshkuj (vetëm 2%). **(Shiko figurën 16.)**

Figura 146: Nevoja për karrierë të suksesshme



Informacione shtesë për faktorët për sukses janë mbledhur përmes të dhënave kualitative nga IIK-të. Këto informacione theksojnë dallime të ndjeshme ndërmjet të rinjve dhe profesionistëve, duke treguar se nevojat variojnë varësisht nga ajo nëse të anketuarit janë “gati të hyjnë” apo “në” fuqinë punëtore ligjore. Një gjetje e rëndësishme është nevoja e shprehur e studentëve për “vetëbesim”, i cili mund të jetë më i lartë tek studentet femra sesa te ata meshkuj siç paraqitet nga aftësia më e ulët e studenteve femra për të përkufizuar nevojat e tyre për karrierë të suksesshme sesa homologët e tyre meshkuj. **(Shiko figurën 17.)**


Figura 157: Çfarë ju nevojitet që të arrini sukses në karrierën tuaj ligjore?

Nevojat e profesionistëve	Nevojat e studentëve
<ul style="list-style-type: none"> Motivimi, përkushtimi dhe dëshira e vullneti për të punuar Mbështetja nga familja dhe nga shteti, në veçanti për profesionistët e rinj dhe profesionistet femra Përgatitja profesionale, trajnimi dhe zhvillimi profesional 	<ul style="list-style-type: none"> Vetëbesimi Integriteti moral dhe personal dhe distanca nga politika Njohja e ligjeve në fushën e praktikës

<ul style="list-style-type: none"> • Të menduarit analitik dhe kritik, një kulturë e të menduarit si avokat, dhe kapaciteti për të bërë hulumtime. • Përvoja • Kreativiteti • Performanca 	<ul style="list-style-type: none"> • Studimi i vazhdueshëm • Përvoja praktike • Pjesëmarrja në aktivitete shtesë në dispozicion
---	--

Në pyetjen se çfarë do të tërhiqte të rinjtë e në veçanti femrat e reja për të hyrë në fuqinë punëtore ligjore, të anketuarit profesionistë janë përgjigjur mjaft shumë “më shumë mundësi për avancim” (74% e të gjithë të anketuarve, 72% e profesionisteve femra). Të anketuarit profesionistë po ashtu kanë theksuar respektin dhe prestigjin publik (55% e të anketuarve profesionistë, 55% e femrave profesioniste), paga më të larta (45% e të anketuarve profesionistë, 40% e femrave profesioniste), dhe mbështetje shtesë për familje siç është qasja në kujdesin e fëmijëve dhe në strehim (30% e të gjithë të anketuarve profesionistë, 44% e femrave profesioniste). Femrat profesioniste kanë renditur kushtet familjare dhe kujdesin ndaj fëmijëve shumë më lart sesa homologët e tyre meshkuj dhe kanë vlerësuar se do të përbënte një dobi më tërheqëse sesa rritja e pagës. Të rinjtë i kanë vënë më shumë theks respektit publik dhe prestigjit (67%) dhe perspektivës së karrierës dhe avancimit (69%), duke theksuar rëndësinë e rrugës së përkufizuar për karrierë, respektit dhe rritjes profesionale në motivimin e zgjedhjeve në mesin e të diplomuarve të rinj. Pagat (31%) dhe përfitimet familjare (21%) janë radhitur si më të ulëta sesa në mesin e profesionistëve. **(Shiko figurën 18.)**

Figura 16: Kushtet për të tërhequr të rinjtë dhe femrat në fuqinë punëtore ligjore



Të rinjtë të anketuar kishin një perceptim të ndarë sa i përket asaj se cili profesion është më tërheqësi për të diplomuarit në juridik, dhe se çfarë profesioni ata kanë planifikuar ta ushtrojnë pas diplomimit. Profesionet më tërheqëse ishin perceptuar të jenë gjyqtar (34%), pasuar me avokat (28%), dhe profesione e lira siç është noteria dhe përmbarues (19%). Duke krahasuar, planet e menjëhershme të karrierës kanë treguar se të rinjtë e diplomuar ka pasur më shumë të ngjarë të bëhen avokatë (31%) pasuar me gjyqtarë (26%) dhe noterë apo përmbarues (18%). Nga të dhënat kualitative, IIK dhe DGF, shumica e studentëve kanë thënë se ata donin të bëheshin gjyqtarë, avokatë, prokurorë dhe noterë apo përmbarues privatë. Në pyetjen se përse studentët kanë dhënë shpjegimet në vijim:

- Unë dua të bëhem **gjyqtar**: për të pasur prestigj në shoqëri, sepse është një profesion sfidues, dhe për të specializuar në ndonjë fushë specifike siç është e drejta kushtetuese.
- Unë dua të bëhem **avokat**: për t'u ofruar këshilla ligjore qytetarëve, për të pasur prestigj në shoqëri, për të rritur numrin e avokateve femra, për të fituar përvojë dhe ndoshta më vonë për të kaluar në profesione tjera ligjore, dhe sepse është një profesion i lirë.

- Unë dua të bëhem **prokuror**: për të luftuar kriminalitetin.
- Arsyja e vetme e dhënë për aspirim në profesionet e noterisë dhe përmbaruesit privat ishte se është profesion i ri.

Këto informacione mund të përdoren për të vazhduar inkurajimin dhe motivimin e studentëve dhe juristëve të rinj për të ndërmarrë hapa drejt hyrjes në profesione në të cilat ata aspirojnë të hyjnë në fuqinë punëtore ligjore dhe për të ofruar mundësi për ndërtimin e kapaciteteve dhe zhvillimin profesional për të rinjtë dhe femrat profesioniste ligjore përmes programeve të reja.

Profilet e femrave dhe të rinjve në fuqinë punëtore ligjore: Të dëgjohet zëri ynë përmes profesionalizmit dhe mundësive të reja

Të dhënat kualitative dhe kuantitative nga Iniciativa Hulumtuese për të Rinjtë dhe Femrat theksojnë sfidat për të hyrë dhe për tu avancuar në fuqinë punëtore ligjore që mund të kategorizohen në dy fusha: strukturore/shoqërore dhe ndër-personale/të brendshme. Çështjet strukturore dhe shoqërore siç janë pritjet e ndryshme familjare dhe të komunitetit për meshkuj dhe femra, klientët që preferojnë avokatët meshkuj, mundësi të pamjaftueshme për të rinj të diplomuar, si dhe mungesa e roleve të udhëheqjes për femrat dhe kufizimet në avancim paraqesin të gjitha kufizimet aktuale dhe të vërteta për hyrjen e të rinjve dhe femrave si dhe për avancimin në profesionet ligjore.

Studentët e juridikut dhe profesionistët e rinj

Të dhënat kualitative kanë zbuluar se femrat studente të juridikut dhe profesionistët e rinj kanë aspirata të larta dhe motivimin për të hyrë në profesionin ligjor. Arsyet më të shpeshta që janë dhënë për atë se përse ata do të donin të hyjnë në profesionin ligjor ishin: dëshira për të bërë drejtësi, prestigji dhe kohëzgjatja, dëshira për të ndryshuar shoqërinë dhe për të ndihmuar vendin e tyre, për të luftuar korrupsionin, dëshira për të ndihmuar ata të drejtat e të cilëve janë shkelur, për të studiuar ligjet dhe për të ditur të drejtat dhe për ti mësuar te tjerët për te drejtat e tyre, pozita e mirë që ofron profesioni ligjor, për të krijuar ndryshime pozitive në gjyqësor, motivim familjar dhe se profesioni ligjor krijon mundësi për të punuar në shumë institucione.

Megjithatë, kur janë pyetur në lidhje me atë se me çfarë barrierash ndeshen ata lidhur me hyrjen dhe avancimin në profesionin ligjor, të rinjtë e ligjit kanë identifikuar se dy sfida më të mëdha ishin: (1) mungesa e mundësive praktike për të iu mundësuar studentëve ose të rinjve të diplomuar për përcaktimin e një rruge karriere në kuadër të fuqisë punëtore ligjore dhe (2) papunësia. Lidhur me mungesën e mundësive praktike, studentët kanë thënë se mësimi praktik dhe klinikat ligjore janë me më shumë teori sesa praktikë, dhe se ata gjithashtu nuk kanë mundësi të bëjnë punë praktike. Pa fituar përvojë praktike, të rinjtë e diplomuar nuk mund të kualifikohen për të marrë një punë ligjore/profesionale për herë të parë dhe të fillojnë karrierën ligjore. Kjo është arsyeja pse një profesor i juridikut ka rekomanduar që "mësimi praktik" të jetë edhe më praktik, dhe se përvoja praktike/programet e praktikës duhet të jenë të detyrueshme për studentët e juridikut. Shqetësimi tjetër kryesor për studentët dhe të diplomuarit është papunësia. Papunësia është e lidhur me pengesën e parë, për shkak se mungesa e mundësive praktike gjatë studimeve ligjore pasqyron vështirësitë e fillimit të profesionit ligjor pas diplomimit. Pjesëmarrja e të rinjve në DGF po ashtu ka identifikuar mundësi specifike të interesave për zhvillim profesional, duke përfshirë punën praktike në gjykata, OAK, dhe institucione tjera ligjore; pjesëmarrjen në klinikat ligjore; trajnimin praktik shtesë dhe tryezat profesionale.

Profesionistët: Avokatët, gjyqtarët dhe prokurorët

"Rolet e udhëheqjes ruhen për meshkuj. Në të gjitha pozitat kyçe në gjyqësor, meshkujt janë dominues."

Kryetarja e Bordit të Forumit të Gjyqtareve dhe Prokurorëve

Profesionistët të cilët morën pjesë në Inicativën Huluntuuese për të Rinjtë dhe Femrat kanë demonstruar se ekziston barazi gjinore në sektorin e drejtësisë, por ka mungesë të mundësive për juristët e rinj. Shumica gjithashtu janë pajtuar se meshkujt dhe femrat kanë mundësi të barabarta në profesionin ligjor, por disa gjithashtu kanë theksuar se femrat përballen me sfida në avancimin e karrierës së tyre veçanërisht në marrjen e gradimeve në rolet udhëheqëse.

Iniciativa Huluntuuese për të Rinjtë dhe Femrat ka përfshirë IIK-të me disa profesionistë ligjor me ndikim, avokatë, gjyqtarë, prokurorë, dhe profesorë të juridikut. Shumica e femrave në profesionet ligjore janë pajtuar se nuk ka shumë mundësi për avancim, veçanërisht për rolet e udhëheqjes. Një avokat i OAK-së është shprehur se "udhëheqësia e OAK-së janë tërësisht meshkuj dhe asnjë femër nuk është anëtare e Këshillit Drejtues të OAK-së", si dhe Kryetarja e Bordit të Forumit të Gjyqtareve dhe Prokurorëve, një gjyqtare e Gjykatës së Apelit, ka thënë se "rolet udhëheqëse ruhen për meshkuj. Në të gjitha pozitat kyçe në gjyqësor, meshkujt janë dominues."

Avokatët e rinj që kanë marrë pjesë në IIK kanë deklaruar se kanë qenë profesionalisht aktiv edhe vetë dhe kanë arritur suksese duke qenë aktivë, por pak mbështetje është ofruar nga avokatët më me përvojë. Disa gjyqtarë dhe prokurorë të niveleve të larta të cilët janë intervistuar kanë thënë se sistemi gjyqësor në Kosovë nuk jep hapësirë të mjaftueshme për brezin e ri, veçanërisht lidhur me angazhimin në gjykatat dhe prokurori si praktikantë dhe bashkëpunëtorë profesional, që është një hap i parë i rëndësishëm drejt një karriere ligjore të suksesshme. Avokatët dhe gjyqtarët e rinj kanë rekomanduar që sistemi gjyqësor të strukturohet në një mënyrë që do të hapë më shumë mundësi për të diplomuarit.

Në tërësi, profesionistët ligjor kanë shprehur interes në zhvillimin e tyre profesional dhe në trajnimin për të drejtën penal, të tilla si krimi i organizuar, terrorizmi dhe krimet e luftës; menaxhimi i gjykatave; e drejta ndërkombëtare dhe arbitrimi; drejtësia për të mitur; zbatimimi i ligjeve të miratuara rishtazi, ligjin ekonomik dhe intervistonim të klientëve dhe trajnimin për profesorët lidhur me marrëdhëniet profesor-student.

Adresimi i sfidave strukturore dhe shoqërore

Femrat kanë identifikuar mbështetje nga partnerët e tyre, familjet dhe kolegët si faktori më i rëndësishëm në adresimin e sfidave strukturore dhe shoqërore të tilla si balancimi i pritjeve të punës/jetës, familjes dhe komunitetit dhe paragjykimet apo ngacmimi në vendin e punës. Femrat profesioniste dhe studentët kanë identifikuar se ato më së shumti janë në gjendje të kenë sukses kur shokët e tyre të klasës, bashkëshortët dhe kolegët janë përkrahës të suksesit të tyre.

Shumica e pjesëmarrësve kanë pranuar se kur bëhet balancimi i punës me obligimet e brendshme, barra e kujdesit për fëmijë dhe punë të shtëpisë kryesisht bie mbi femrat, por kanë vënë në dukje se situata është përmirësuar në vitet e fundit dhe meshkujt janë bërë më shumë mbështetës. Femrat që kanë balancuar me sukses jetën në shtëpi dhe punë kanë thënë se është me rëndësi që të ketë mbështetjen e burrave të tyre dhe nga familja e zgjeruar. Një gjyqtare e Gjykatës Themelore në Ferizaj, ka thënë se "është e vështirë të balancohen obligimet e punës dhe shtëpisë, por me mbështetjen e burrit tim unë ia dal të kryej punën mirë në profesion

"Është e vështirë të balancohen obligimet e punës dhe shtëpisë, por me mbështetjen e burrit tim unë ia dal të kryej punën mirë në profesion dhe në shtëpi".

Gjyqtare nga Gjykata Themelore në Ferizaj

dhe në shtëpi". Një gjyqtare tjetër nga Gjykata Themelore e Mitrovicës tha se "është e vështirë për mua të bëj këtë ekuilibër, pasi që unë jam duke punuar me të miturit, dhe unë jam në punë gjithë kohën, dhe nuk ka shumë kohë për t'u kujdesur për familjen". Përgjithësisht, meshkujt dhe femrat pjesëmarrës janë pajtuar se meshkujt dhe femrat profesionist kanë nevojë të menaxhojnë kohën dhe të ndajnë përgjegjësitë për të siguruar që aktivitetet e tyre profesionale dhe obligimet personale mund të përmbushen.

Megjithëse profesionistët femra vazhdojnë të luftojnë me strukturat patriarkale dhe paragjykimet gjinore, nevojat të cilave u jepet prioritet më i lartë nga femrat pjesëmarrëse janë përmirësimi i aftësive të tyre profesionale dhe mundësia për të punuar edhe më tepër për të arritur në pozita menaxheriale dhe udhëheqëse. Në intervista, femrat profesioniste - veçanërisht ato me shumë vite përvojë - pranojnë se për të adresuar sfidat që ato ndeshin si gjyqtare dhe avokate, ato duhet të jenë profesioniste të forta dhe të fuqizuara. Si rezultat, një objektiv parësor në të iniciativat e ardhshme profesionistët femra, profesionistët e rinj dhe femrat e diplomuara, duhet të jetë rritja e vetë-efikasitetin e femrave profesioniste duke inkurajuar rritjen e besimit, promovimin e modeleve të udhëheqjes dhe të ndihmuarit të rinjtë për tu zhvilluar profesionalisht dhe për të hyrë në fuqinë punëtore ligjore.

Ndërtimi i profesionalizmit

Tri sfidat më të mëdha të identifikuara nga studentët e juridikut në FJUP dhe Kolegjin Iliria ishin papunësia, nepotizmi në rekrutimin, dhe mungesa e mundësive për përvojë praktike. Pjesëmarrësit kanë thënë se shqetësimi më i madh i tyre është se ata do të mbarojnë fakultetin dhe nuk do të kenë një vend ku mund të fillojnë punën dhe ata nuk do të kenë mbështetje financiare nëse ata duan të fillojnë karrierën e tyre si profesionistë të pavarur ligjor, siç është avokati apo noteri. Këto shqetësime kanë potencial që të rezultojnë në kufizime të vetë-imponuara për ndjekjen e mundësive në fuqinë punëtore ligjore, siç e ndajnë të rinjtë ata thjesht nuk do të arrijnë sukses në hyrje në këto karriera apo për të përparuar profesionalisht.

Studentët pjesëmarrës pajtohen se për të qenë avokat apo gjyqtar i suksesshëm, i pavarësia, paanshmëria dhe drejtësia janë thelbësore. Një pjesëmarrës në DGF ka thënë: "Qëllimi im është të bëhem prokuror. Unë do të jem një prokuror i drejtë dhe i paanshëm, dhe dua të u tregoj të tjerëve se sistemi mund të ndryshohet me profesionistë të drejtë e të paanshëm." Një nxënës tjetër pjesëmarrës në një IIK në Kolegjin Iliria deklaroi se "unë vendosa të studioj sepse është një profesion sfidues. Nëpërmjet profesionit ligjor, unë do të përmbushë qëllimin për jetën time, të ndaj drejtësi në vendin tim."

"Ëndrra ime është të bëhem një prokuror. Unë do të jem një prokuror i drejtë dhe i paanshëm, dhe dua të u tregoj të tjerëve se sistemi mund të ndryshohet me profesionistë të drejtë e të paanshëm."

Studente në baçelor, FJUP

Ndërtimi i vetëbesimit

"Unë jam inkurajuar për të ndjekur një karrierë ligjore nga një gjykatëse e lartë femër në një ligjëratë publike. Ajo dha shembuj nga përvojat e saj se si të jemi të suksesshëm në karrierën ligjore."

Studente në baçelor, FJUP

Vetë-besimi është ngritur shumë herë në IIK dhe DGF, veçanërisht me studentët e rinj të juridikut, të cilët ishin duke u përpjekur të hyjnë në fuqinë punëtore ligjore. Studentët e juridikut dhe femrat e reja profesioniste ligjore kanë perceptuar përafërsisht nivele të barabarta të barazisë gjinore në arsim dhe punësim. Këto perceptime u konfirmuan në DGF me studentë nga FJUP dhe Kolegji Iliria. Studentët aktual dhe profesionistët e rinj ligjor kanë përfitur nga përpjekjet për të rritur bashkëveprimin në mes të të rinjve dhe profesionistëve zbatuar përmes Programit të PJK-së të USAID-it

ndërmjet 2012 dhe 2015, duke përfshirë seritë e paneleve profesionale, takimet e rrjeteve të femrave dhe programet e praktikës. Studentët e juridikut kanë ndërtuar besimin për të shqyrtuar karrierën në fuqinë punëtore ligjore duke u bërë më të njohur me përvojat aktuale të gjykatësve, avokatëve profesional dhe profesionistë të tjerë ligjorë. Një praktikante e OAK-së nga FJUP ka thënë se: "Unë jam inkurajuar për të ndjekur një karrierë ligjore nga një gjykatëse e lartë femër në një ligjëratë publike. Ajo dha shembuj nga përvojat e saj se si të jemi të suksesshëm në karrierën ligjore."

Krijimi i mundësive për brezin e ardhshëm të profesionistëve ligjor

Vështirësi në gjetjen e një institucioni për punë praktike është përmendur nga studentët dhe të rinjtë e diplomuar si një pengesë e madhe për të hyrë në fuqinë punëtore ligjore. Në IIK, avokatët dhe gjykatësit kanë pranuar se mungesa e mundësive rezulton në papunësi dhe se kjo papunësi e brezit të ri përfundimisht do të ndikojë negativisht në sektorin e drejtësisë dhe harmonizimin e fuqisë punëtore ligjore. Të dhënat mbi moshën e profesionistëve ligjor në tërë profesionet tregojnë se harmonizimi i fuqisë punëtore ligjore është plakja e cila paraqet rrezik të humbjes së gjysmës së anëtarëve të vet brenda pesë deri dhjetë vitet e ardhshme derisa profesionistët arrijnë moshën e pensionimit. Një gjykatës nga Gjykata Themelore e Gjakovës (dega e Malishevës) tha se "mos-përfshirja e brezit të ri, veçanërisht nga paaftësia për të plotësuar kushtin e përvojës tre-vjeçare, është një pengesë për brezin e ri për të iu bashkuar gjyqësorit." Një gjyqtar tjetër është pajtuar me këtë dhe ka thënë se "sistemi gjyqësor në Kosovë nuk është i organizuar në një mënyrë që i jep mundësi brezit të ri pas diplomimit." Një avokat i OAK-së ka thënë se "pengesa e parë më e madhja për të rinj të diplomuar është papunësia; askush nuk është duke menduar për këtë, qeveria duhet të bëjë më shumë për të rinjtë. Të rinjtë e arsimuar po e lëshojnë Kosovën, ata thjeshtë nuk gjejnë perspektivë këtu."

Mbushja e hendekut ndërmjet arsimimit ligjor dhe fuqisë punëtore

Të rinjtë kanë shprehur kënaqësi me arsimin dhe në përgjithësi kanë konsideruar se janë përgatitur mirë për të hyrë në fuqinë punëtore. Megjithatë, shumë te anketuar pjesëmarrëse në anketë dhe DGF që janë zhvilluar në FJUP dhe në Kolegjin Iliria shprehën pasiguri nëse ata ishin të gatshëm për fuqinë punëtore dhe vunë në dukje mungesën e përvojës së mjaftueshme praktike në mesin e tri sfidave kryesore që prekin aftësinë e tyre për të hyrë në fuqinë punëtore ligjore pas diplomimit. Shumë studentë janë të etur të regjistrohen në praktikë si një hap i ndërmjetëm që mund të çojë në hyrjen në botën profesionale. DGF-të e kryera me praktikantët nga OAK-ja dhe nga gjykatat e Malishevës dhe Skenderajt kanë konfirmuar rëndësinë e përvojë praktike për të ndihmuar të rinjtë për tu përgatitur për provimin e jurisprudencës dhe për të filluar karrierën e tyre ligjore. Të gjithë praktikantët janë mirënjohës ndaj OAK-së dhe atyre gjykatave të cilat hapen dyert për ta dhe u dhanë atyre mundësi për të mësuar nga avokatë dhe gjykatës profesionistë. Për të konfirmuar rëndësinë e praktikës dhe përvojës, shumica e profesionistëve të intervistuar kanë thënë se ata kanë filluar karrierën e tyre ligjore si praktikantë, qoftë me gjykata, prokurori, ose OAK, dhe se ata hapa të parë të karrierës së tyre ligjore janë sukseset kryesore për ata, pasi gjetën punë në institucionet ose se ato praktika kanë ndihmuar ata të gjejnë një punë dhe të jenë të suksesshëm në karrierën e tyre.

Derisa numri i klinikave ligjore dhe mundësitë e praktikës janë rritur ndjeshëm me mbështetjen e Programit të USAID-it, PJK, për studentët e FJUP-së dhe Kolegjit Iliria, ka ende shumë studentët në juridik që diplomojnë dhe nuk kanë pasur ndonjë përvojë praktike qoftë në mënyrë akademike nëpërmjet klinikave ligjore ose jashtë nëpërmjet programeve të praktikës. Profesionistët që kanë marrë pjesë në IIK vunë në dukje gjithashtu se mësimi praktikë dhe klinikat ligjore nuk janë ende

"Unë do të rekomandoja që përvojë praktike të jetë një kusht që në vitin e parë të studimeve ligjore. Studentët duhet të inkurajohen të kryejnë punë praktike në institucione të ndryshme. Dhe [fakultetet juridike duhet] të fusin klinika mësimore më praktike/klinikat ligjore edhe në tema tjera."

FJUP, Profesoreshë e klinikës juridike

